

# Menaxhimi i Buxhetit dhe Financimi i RTK-së

Qershor, 2015



# Hyrje

- Më 29 mars 2012 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës. Sipas këtij ligji, RTK financohet nga katër burime të ndryshme: nga parapagimi, nga Kuvendi, nga vetëfinancimi dhe nga burimet tjera.
- Edhe pse financimi nga parapagimi llogaritet si mekanizmi kryesor dhe afatgjatë i financimit, ligji lejon që për një periudhë tranzitore, deri trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së t'i ndahet 0.7% e të hyrave nga Buxheti i Kosovës.
- Megjithatë, ligji kërkon nga menaxhmenti i RTK-së që brenda gjashtë muajve nga hyrja e ligjit në fuqi t'i propozojë Bordit të RTK-së mekanizmin për mbledhjen e parapagimit. Menjëherë pas aprovimit nga ana e Bordit, Kuvendi obligohet ta miratojë mekanizmin për mbledhjen e tarifës nga parapagimi, përfshirë edhe shumën e tarifës, brenda 12 muajve nga hyrja e ligjit në fuqi.
- Tri vite pas miratimit të ligjit asnjëra nga këto obligime ligjore nuk është realizuar. Periudha tranzitore trevjeçare e financimit nga Buxheti i Shtetit tashmë ka përfunduar, kurse mekanizmi për mbledhjen e parapagimit nuk është gjetur.
- Andaj, para se Kuvendi i Kosovës të mendojë për plotësim-ndryshimin e Ligjit për RTK-në, Kuvendi duhet të kërkojë llogari nga Bordi dhe menaxhmenti i RTK-së përse nuk i kanë kryer obligimet ligjore të lartpërmendura. Konkretisht, përse nuk e kanë gjetur mekanizmin për mbledhjen e parapagimit gjatë gjithë kësaj periudhe?
- Në tetor 2011, Instituti GAP i pat ofruar Komisionit Parlamentar për Media një analizë me titull *Qëndrueshmëria Financiare e RTK-së - gjetja e alternativave për financimin e transmetuesit publik*, ku GAP kishte propozuar shtatë alternativa për financimin e RTK-së përmes

parapagimit.<sup>1</sup> Megjithatë, Kuvendi vendosi që RTK të financohet direkt nga Buxheti i Shtetit.

- Të kujtojmë se RTK ishte financuar përmes parapagimit të qytetarëve për një periudhë gjashtë vjeçare gjatë viteve 2003-2009. Gjatë kësaj periudhe KEK kishte shërbyer si inkasantë i parapagimit përmes faturave të energjisë elektrike. Që nga ndërprerja e kontratës në mes të KEK-ut dhe RTK-së më 30 nëntor 2009 deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për RTK-në më 2012, RTK është financuar në mënyrë ad-hoc nga Buxheti i Shtetit. Nga viti 2012 RTK vazhdon të financohet nga Buxheti i Shtetit, tashmë me formulën 0.7%.

## Problemet me financimin dhe menaxhimin e buxhetit

- Financimi direkt nga Buxheti i Shtetit është kritikuar dy vjet radhazi nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian (2013 dhe 2014), i cili konstaton se forma e tanishme e financimit nga buxheti i shtetit cenon pavarësinë editoriale dhe se Kosova ende nuk e ka gjetur mënyrën për të siguruar pavarësinë financiare të RTK-së.
- Formula buxhetore e ndarjes së grantit në shumën prej 0.7% nga të hyrat e Buxheti të Shtetit, deri më tani është dhënë në mënyrë paushall, pa ndonjë planifikim të hollësishëm buxhetor.
- Kjo mënyrë e financimit, e cila në mas të madhe varet nga vullneti politik dhe paraqet një formë jo të qëndrueshme të financimit, ka zhytur RTK-në në borxh. Edhe pse buxheti total i RTK-së është rritur përgjatë viteve, rritja e borxhit të jashtëm tregon se RTK nuk ka qenë në gjendje që përmes të hyrave të saj ta përballojë koston operative. Borxhi i jashtëm i RTK-së është

---

<sup>1</sup> **Burimi:** [http://www.institutigap.org/documents/93579\\_RTK.pdf](http://www.institutigap.org/documents/93579_RTK.pdf)

rritur nga 3.3 milion euro në vitin 2013 në 4.3 milion euro në vitin 2014. Kësisoj, edhe raporti ndërmjet borxhit dhe ekuitetit është rritur në 75%.<sup>2</sup>

- Në raportin financiar për vitin 2014 të RTK-së, i dorëzuar pranë Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, thuhet se për periudhën raportuese janar-dhjetor 2014 RTK ka realizuar gjithsej 11,676,085 euro nga të ardhurat e dedikuara, ndërsa ka shpenzuar më shumë se sa ka pasur të ardhura, saktësisht 12,110,363 euro. Përqindja e realizimit të buxhetit, thuhet në këtë raport, për paga dhe mëditje ka qenë 114% kurse për investime kapitale 62%. Në përgjithësi del se investimet kapitale janë lënë anash në favor të pagave dhe mëditjeve. Nga buxheti prej 12,110,363 euro, 6,869,864 euro janë shpenzuar për paga dhe mëditje.
- Nga ky raporti financiar shihen tejkalimet që janë bërë tek pagat dhe mëditjet. Për 11 anëtarët e Bordit të RTK-së, me Ligjin për Buxhetin kanë qenë të aprovuara 110,000 euro për paga dhe mëditje, kurse janë shpenzuar 152,594 euro. Kjo nënkupton se mesatarisht çdo anëtar i bordit të jetë paguar nga 13,872 euro në vit, apo 1,156 euro në muaj. Ndërkaq, për 7 anëtarët e menaxhmentit të lart janë shpenzuar gjithsej 156,723 euro për paga për vitin 2014, apo mesatarisht nga 22,389 euro për person, apo nga 1,865 euro në muaj.
- Tejkalime buxhetore në masë të madhe janë bërë edhe për pagat dhe mëditjet e punonjësve të tjerë. Kështu nga buxheti i aprovuar prej 5,710,000 euro për 690 punonjës, janë shpenzuar gjithsej 6,560,547 euro. Marr në përgjithësi, nga 6 milion euro sa kanë qenë të aprovuara për paga dhe mëditje, janë shpenzuar mbi 6.8 milion euro.
- Mos pengimi i tejkalimit të shpenzimeve të RTK-së në krahasim me të ardhurat, nënkupton për shkelje ligjore nga ana e Bordit të RTK-së. Sipas Ligjit për RTK, një ndër kompetencat e Bordit është shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit vjetor duke u siguruar që "shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare" (Neni 29, pika 2.9).

---

<sup>2</sup> Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të RTK-së për vitin 2014, <http://bit.ly/1cVTpBd>

*Buxheti i RTK-së 2006-2015*

Viti	Nga parapagimi (KEK)	Nga Buxheti i Kosovës	Nga Marketingu	Të tjera	Gjithsej
2015		9,768,500 <sup>3</sup>			
2014		9,348.000	2,072.000	256.000	11,676.000
2013		9,761.000	1,919.000	136.000	11,816.000
2012		8,910.000	1,776.000	174.000	10,860.000
2011		7,900.000	1,474.000	212.000	9,586.000
2010		10.464.000	1.733.817	107.345	12.305.162
2009	7.080.276		2.540.445	164.321	9.785.042
2008	8.652.000		1.493.000	244	10.389.000
2007	7.991.363		1.526.519	294.4	9.812.282
2006	7.080.000		1.432.654	325.334	8.837.988

*Burimi: Raportet e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare (www.rtklive.com)*

<sup>3</sup> Tabela e Buxhetit të Kosovës për vitin 2015, <http://bit.ly/1EUCNjI>

# Rekomandimet e Institutit GAP

Duke e konsideruar situatën e financimit të RTK-së si jo të mirë, ne kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si themelues i Radiotelevizionit të Kosovës dhe si mbikëqyrës i tij, që të adresojë me urgjencë çështjet në vazhdim:

- Të kërkojë llogari nga Bordi dhe menaxhmenti i RTK-së përse nuk është gjetur mekanizmi i financimit nga parapagimi brenda afatit ligjor;
- Të kërkohet nga RTK një raportim i hollësishëm buxhetor për të parë përse është shpenzuar më shumë se sa që kanë qenë të hyrat dhe përse është thelluar raporti mes borxhit dhe ekuitetit;
- Të kërkohet llogari përse është tejkalluar buxheti i aprovuar për paga dhe mëditje për anëtarët e bordit. Në vend se të kërkohet llogari përse kanë dështuar për gjetjen e makanzimit të financimit nga parapagimi, anëtarët e bordit janë shpërblyer me të ardhura shtesë, duke tejkalluar buxhetin e aprovuar me ligj për 42,594 euro;
- Të kërkohet nga RTK një planifikim i hollësishëm i projeksioneve buxhetore për vitet në vazhdim, në mënyrë që të shihet qartë se cilat janë kërkesat buxhetore të transmetuesit publik;
- Mekanizmi i financimit të RTK-së që nga viti 2010 ka qenë financim i paqëndrueshëm, i paparashikueshëm, thellësisht i varur nga vullneti politik i partisë në pushtet, dhe tejet i paqartë dhe jo transparent për publikun kosovar;



**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)